REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 384/1 Prot. Durrës, më 30.03.2021

# VENDIM

## Nr 14, datë 30.03 2021

## "PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEN NË MASËN 100% NGA TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021"

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, VKM nr.698, datë 21.11.2018 Për një shtesë në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", VKM nr.779, datë 26.12.2018 " Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit

**VENDOSI:**

1. Përjashtimin në masën 100%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklit e parë me kohë të plotë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 65 studentë, efekti financiar 1625000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
   - Administratori
   - Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**
**Ilirjana NANO**

**Cikli I pare I studimeve me kohe te plote**

Perjashtuar ne masen 100% nga tarifa e shkollimit per vitin akademik 2020-2021

| FAKULTETI | Nr. Shkreses | Kriteret | | | | | | | | | | | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Kriteri Nr.1** Studente, Familjet e te cileve trajtohen me Ndihme Ekonomik | **Kriteri Nr.2** Bashkeshorte t qe kane femije dhe jane te dy studente. | **Kriteri Nr.3** Studente, Persona me aftesi te kufizuar te vertetuar nga KMCAP | **Kriteri Nr.4** Studentet qe I kan te pakten njerin prinderit me aftesi te kufizuar te vertetuara | **Kriteri Nr. 5** Studentet qe I kan te dy prinderit pensioniste (ose njeri prind pensionist dhe tjetri | **Kriteri Nr. 6** Studentet, te tretet ne radhe, te cilet vijne nga familje me tre e me shume | **Kriteri nr.7** Studente, qe kane perfituar statusin e jetimit, deri ne moshen | **Kriteri nr.8** Studente qe kane humbur kujdestari ne prinderor e me | **Kriteri Nr. 11** Studentet rome dhe ballkano - egjiptiane, te konfirmuar si te tille nga | Studentet femije te punonjesve te Policise se Shtetit te rene ne krye te detyres | **Kriteri nr.12** Studente , femije te ish te denuarve dhe te perndjeku rve | Studente me mesatare mbi 9 (nente) | | Efektet finaciare per vitin akademik 2020-2021 |
| Fakulteti I Biznesit | **Shkresa nr.128 date 08.02.2021** | 3 | | | 2 | | | | | | | | | 5 | 125000 |
| Fakulteti I Biznesit | **Shkresa nr.235 date 10.03.2021** | 2 | | | | | | | | | | | | 2 | 50000 |
| Fakulteti I Teknologjise se Informacionit | **Shkresa nr. 46 date 02.03.2021** | 1 | | | 3 | | | | | | | | | 4 | 100000 |
| Fakulteti Edukimit | **Shkresa nr.05 date 06.01.2021** | | | | | | | | | | | | | 0 | 0 |
| Fakulteti Edukimit | **Shkresa nr.338 date 23.02.2021** | 2 | | | | | | | | | | | | 2 | 50000 |
| Fakulteti I Shkencave Politike Juridike | **Shkresa nr.68/1 date 12.2.2021** | 32 | | | 7 | 1 | 1 | 1 | 1 | | | 1 | | 44 | 1100000 |
| Shkencave Politike Juridike | **Shkresa nr.88/1 date 26.02.2021** | | | | 2 | | | | | | | | | 2 | 50000 |
| Fakulteti I Studimeve Profesionale | **Shkresa nr. 111 date 01.03.2021** | 5 | | | | 1 | | | | | | | | 6 | 150000 |
| TOTALI | | 45 | 0 | 0 | 14 | 2 | 1 | 1 | | 0 | 0 | 1 | 0 | 65 | **1625000** |